



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA KOMBËTARE E FINANCIMIT TË ARSIMIT TË LARTË

BORDI DREJTUES

Nr. 65/3 Prot.

Tiranë, më 11.03.2025

VENDIM

Nr. 03 Datë 11.03.2025

PËR

"DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1 DATË 17.02.2025, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE ME TË GJITHË STUDENTËT QË NDJEKIN STUDIMET NË PROGRAME PRIORITARE TË CILËT PËRFITOJNË MBËSHTETJE FINANCIARE, PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025, SIPAS VKM NR.386/2022, I NDRYSHUAR, SI DHE FONDIN PËRKATËS PËR ÇDO INSTITUCION TË ARSIMIT TË LARTË"

Bordi Drejtues i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, mbështetur në nenin 11, dhe 112, të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", pikën 3 dhe 6, të Vendimit nr.397, datë 3.5.2017 të Këshillit të Ministrave "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL)", gërmën "c", të pikës 2, pikën 6, 6/1 dhe 10, të Vendimit nr.386 datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë", i ndryshuar, në pikën 5, të Udhëzimit nr.30, datë 04.11.2022, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit "Për përcaktimin e rregullave dhe afateve të aplikimit, si dhe të procedurave të përcaktimit të masës dhe mënyrës së financimit të studentëve të shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar", i ndryshuar, si dhe në zbatim të Rregullores së Brendshme të Bordit Drejtues të AKFAL,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e listës përfundimtare me të gjithë studentët që ndjekin studimet në programe prioritare, të cilët përfitojnë mbështetje financiare për vitin akademik 2024-2025, sipas VKM nr.386/2022, i ndryshuar, si dhe fondin përkatës për Universitetin Bujqësor të Tiranës, Universitetin Politeknik të Tiranës, Universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan.
2. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
3. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI DREJTUES

KRYETARI
Erzen TOLA

ANËTARËT

Beshir BEJTA

Artan HOXHA

Agron KASA

Spiro BRUMBULLI